

Vendim nr. 150 datë 16.06.2017

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fatmir Hoxha,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Besnik Imeraj,	Anëtar i “ “
Gani Dizdari,	Anëtar i “ “

në datën 16.06.2017 mori në shqyrtim paraprak kërkesën me nr.150 Akti, që i përket:

KËRKUESE: **PARTIA “FORCA RINIA”**

OBJEKTI:

1. Shfuqizimi si antikushtetues i dekretit nr.10351, datë 21.05.2017 të Presidentit të Republikës *“Për një ndryshim në Dekretin nr.9883, datë 05.12.2016 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin.”*.
2. Pezullimi i zbatimit të dekretit nr.10351, datë 21.05.2017 të Presidentit të Republikës deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

SUBJEKT I INTERESUAR: PRESIDENTI I REPUBLIKËS

BAZA LIGJORE: Nenet 92/gj, 93, 131, 134/1/gj të Kushtetutës; nenet 27, 31 dhe 31/a të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”*, të ndryshuar.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Presidenti i Republikës, me dekretin nr.9883, datë 05.12.2016 *“Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin”*, caktoi datën 18 qershor 2017 si datën e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare.

2. Bazuar në marrëveshjen midis partive politike, me anë të së cilës iu kërkua Presidentit të Republikës të ndryshojë datën e zgjedhjeve, doli dekreti 10351, datë 21.05.2017 i Presidentit të Republikës, për ndryshimin e datës së zgjedhjeve në datën 25 qershor 2017.

3. Partia politike “Forca Rinia”, është regjistruar si subjekt zgjedhor me vendimin nr. 122, datë 03.04.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

II

4. **Kërkuesja** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e dekretit të Presidentit të Republikës si antikushtetues duke paraqitur këto pretendime

4.1 Dekreti i dytë i Presidentit të Republikës është antikushtetues, pasi Presidenti i Republikës e kishte ushtruar një herë këtë të drejtë, bazuar në nenin 8 dhe 9 të Kodit Zgjedhor dhe nuk kishte asnjë shkak kushtetues për ta ndryshuar atë, pavarësisht marrëveshjes politike midis partive.

4.2 Data e re e zgjedhjeve e caktuar me dekretin e ri është antikushtetuese, pasi është tej afatit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor.

4.3 Dekreti i Presidentit të Republikës ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi ndryshoi pa asnjë shkak të ligjshëm një pritshmëri ligjore për subjektet zgjedhore dhe zgjedhësit.

4.4 Kërkojmë pezullimin e efekteve të dekretit të Presidentit të Republikës deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata, meqë koha është e shkurtër deri në datën e zgjedhjeve, pra në 25.06.2017.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

5. Kolegji, lidhur me *legjitimitit racione personae*, vlerëson se kërkuesja bën pjesë në rrethin e subjekteve të parashikuara nga nenin 134/1/gj. Referuar pikës 2 të po këtij neni kërkuesja duhet të justifikojë interesin e saj në inicimin e kontrollit kushtetues, sipas objektit. Kërkuesja është subjekt zgjedhor i regjistruar me vendim të KQZ-së dhe si i tillë ka interes të drejtpërdrejt që lidhet me zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë.

6. Lidhur me legjitimitimin *racione temporis*, bazuar në nenin 71/a të ligjit nr.8577/2000 Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese, të ndryshuar,

Kolegji konstaton se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4 mujor të parashikuar nga kjo dispozitë dhe neni 49/3/d të këtij ligji.

7. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vlerëson se Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 131 dhe 134 të Kushtetutës, merr në shqyrtim në shkallë të fundit kërkesat që drejtohet kundër akteve të pushtetit publik që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se akti ndaj të cilit është ushtruar ankim, dekreti i Presidentit të Republikës, i cili është një akt administrativ individual, pasi ka për objekt vetëm caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë. Për këtë arsye, Kolegji çmon se ky akt nuk hyn në juridiksionin e kësaj Gjykate por në juridiksionin e gjykatave administrative dhe për këtë arsye, kërkuuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate me objektin sipas kërkesës.

B. Për kërkesën për pezullim të zbatimit të ligjit.

8. Kërkuuesja ka kërkuar pezullimin e zbatimit të dekretit deri në marrjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese por nuk e ka shoqëruar atë me argumente të nivelit kushtetues, përse ky dekret duhet pezulluar dhe cilat janë pasojat e pariparueshme që mund të vijnë nga zbatimi i tij, sipas kërkesave të nenit 45 të ligjit nr.8577/2000 Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese. Në këto kushte, Kolegji e gjen të pabazuar kërkesën për pezullim të zbatimit të dekretit të Presidentit të Republikës.

C. Për bazueshmërinë prima facie të pretendimeve

9. Për sa i takon bazueshmërisë në themel të pretendimeve të kërkueses, Kolegji vlerëson se ajo nuk ka arritur të paraqesë argumente të nivelit kushtetues lidhur me antikushtetutshmërinë e dekretit dhe është ndalur vetëm tek antiligjshmëria e tij. Konkretisht, kërkuuesja ka paraqitur pretendime se dekreti i Presidentit të Republikës bie ndesh me Kodin Zgjedhor. Përputhja apo jo e dekretit të Presidentit të Republikës me dispozitat e Kodit Zgjedhor nuk është në juridiksionin e kësaj Gjykate, por në juridiksionin e gjykatave administrative apo, sipas rastit, të Kolegjit Zgjedhor dhe si e tillë nuk mund të shqyrtohet nga kjo Gjykatë.

10. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk i plotëson kriteret për të kaluar për shqyrtim në seancë plenare si për mungesë legjitimiteti të kërkueses, ashtu edhe për mungesë të argumenteve të nivelit kushtetues sa i takon pretendimeve të paraqitura në kërkesë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 27, 31 dhe 31/a të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

- Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.